



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr r 60-4228/22

Klinë, dt 23.11. /22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 29.11.2022, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përvendoset të gjithë anëtarët e KKSB-së, dhe prezantoi rendin e ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Raporti për gjendjen e Sigurisë në Komunën e Klinës,
4. Të ndryshme.

Pika 1. Miratimi i rendit të ditës.

Zv.Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj, i pyeti të gjithë anëtarët nëse ishin dakord me miratimin e rendit të ditës, për të kaluar në pikën e dytë.

Pika 2. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Zv.Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Po besoj që të gjithë keni pasur mundësi ta lexoni sepse i kemi dërguar edhe në email-at tuaj, por i keni të gjithë edhe kopje fizike edhe pse tash problem

që t'i shfletoni, shkaku i kohës. Atëherë kush është pro procesverbalit? Në qoftë se keni diçka në lidhje me këtë, po besoj që mundemi edhe në takimin e radhës ta komentojmë.

Të gjithë anëtarët votuan pro miratimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pika 3. Raporti për gjendjen e Sigurisë në Komunën e Klinës.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Shfrytëzoj rastin ta përshëndes komandantin, drejtorin dhe gjithë ju të pranishëm! Ne e dimë që në mbledhjen e kaluar, përpos numrit pak që nuk ishim të kompletuar, që edhe sot jemi ashtu njëjtë, ishim të hendikepuar nga policia që nuk kishim raport për gjendjen aktuale dhe po besoj që komandanti sot është i gatshëm. Në takimin e fundit është arsyetuar për mungesën për shkaqe personale, faleminderit komandant, fjala është për ju.

z.Ragip Bytyqi, Komandant: Përshëndetje për të gjithë ju, nënkyetare, drejtor! Fillimi sht kërkoj falje për mospranim në mbledhjen e kaluar, por kam pasur një rast familjar që e pamundësoi pjesëmarrjen në takim.

Sa i përket sigurisë në zonën tonë, në dhjetë majorin e parë relativisht ka qenë situata e qetë, unë i kam disa statistika t'i prezantoj për ju që edhe ju të jeni në dijeni për rastet të cilat janë paraqitur në polici. Për informacionin tuaj, muajin e fundit kemi pak rritje të aksidenteve, fatkeqësisht, javën e kaluar e kemi pasur një aksident me fatalitet ku besojë që jeni të informuar të gjithë përmes mjeteve të informimit, një kadet policor në fshatin Jashanicë, ka vdekur në vendin e ngjarjes, personat e dyshimtë që e kanë shkaktuar aksidentin kanë ikur nga vendi i ngjarjes. Fillimi sht ngjarjen e kemi trajtuar si vetaksident sepse informacionet bazike në fillim i kemi pasur që ka qenë vetaksident, por në bazë të hetimeve që i kemi realizuar diku rrëth 35h kemi arritur t'i identifikojmë kryerësit e atij aksidenti dhe personat e dyshimtë janë arrestuar dhe janë në paraburgim, pa marrë parasysh që rasti është trajtuar nga njësia e trafikut përkatësisht hetimet rajonale të aksidenteve, rasti është udhëhequr në koordinim me mua dhe rezultati ka qenë i drejtpërdrejt i Policisë në Kline, por na ka ndihmuar stacioni i Policisë së Skenderajt, Istogut dhe Pejës, duke mos përjashtuar për ta falënderuar haptas edhe ekspertin e komunikacionit, Noli ku me kërkesë nga stacioni jonë ka ardhur pa hezitim dhe na ka dhënë mendimet e veta në aspektin profesional, kështu që, përzemërsisht e falënderoj Nolin dhe do të jem mirënjohës ndaj tij.

Kemi pasur gjithsej 24 aksidente, 1 aksident ka qenë me lëndime, po flas për muajin tetor sepse për muajin nëntor ende si kemi përpunuuar statistikat, 23 aksidente me dëme të vogla ose dëme të mëdha materiale, janë shqiptuar 935 gjoba, janë arrestuar 57 persona, prej 57 personave, 9 persona janë ndaluar në stacionin Policor në Klinë, janë konfiskuar 2 armë dhe 80 copë municion, janë realizuar 5 asistime të ndryshme jashtë organizatave të tjera Policore, rastet më sensitive të muajit të kaluar janë: 1 lëndim trupor dhe 3 raste të dhunës në familje. Javën e fundit i kemi 6 vjedhje të rënda në zonën tonë, është shqetësuese sepse 6 vjedhje ka kohë që nuk na kanë ndodhur dhe jemi duke e bërë të pamundurën që këtë grup që po i shkaktojnë këto vjedhje,

t'i arrestojmë, por shqetësuese është se për 10 ditë, 6 vjedhje të rënda që kur kam ardhur në Klinë nuk kanë ndodhur. Unë këtu shfrytëzoj rastin të kërkoj ndihmë nga popullata dhe nga ju, që në qoftë se kanë ndonjë informacion tretë këtyre grupeve të na ndihmoni, sepse edhe ne nganjëherë e kemi të vështirë ku dy javët e fundit kemi qenë komplet të angazhuar në veri, normal që detyrat tona ditore nuk i kemi lënë me një anë por angazhimi ynë jashtë Klinës ka ndikuar dhe tash i kemi pak ato efektet negative, kjo është në pika të shkurtra. Nëse ka ndokush ndonjë pyetje jam i gatshëm për përgjigje dhe, edhe njëherë kërkoj falje që në takimin e kaluar kam munguar.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit komandant, nëse ka ndokush të shtojë diçka për pikën e tretë të rendit të ditës, ne raportin e morëm por nëse ka ndokush ndonjë të gjetur, që si bashkësi ose komunë s'kemi njohuri kishte me qenë mirë përndryshe kalojmë tutje, po, Josip?

Z.Josip Dedaj: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë! Sa i përket sigurisë, gjithçka ka qenë në nivel vetëm duke i pasur parasysh vërshimet që janë bërë javën e kaluar ka qenë ndoshta më e arsyeshme me qenë drejtori i Shërbimeve Publike këtu, të na tregojë prej krejt komunën e Klinës, në fushën këtu ku janë ndërtuar shumë shtëpia ka pasur shumë përmbytje si gjithkund në nivel vendi, mirëpo komuna a është në gjendje të ju dalë në ndihmë atyre personave, shtabi juaj emergjent a ka marr ndonjë vendim, sepse shtabi duhet me u krijuar para se të bëhen vërshimet, ku gati çdo të dytin vit kemi këso pasoja ku ka dëme materiale goxha të mëdha.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit, Josip! Siguria në Bashkësi, i ka anëtarët e vet të përcaktuar që është rregullore e rregulluar me ligj, ju e dini, prej drejtorëve është drejtori i Arsimit dhe pjesa tjeter e drejtorëve nuk janë të përfshirë në KKSB.

Sa i përket vërvimeve, të gjithë e dimë si është situata dhe ekipin për emergjencë e kemi formuar edhe me herët, por e kemi formuar edhe për situatën që ndodhi, unë nuk e di që ka mbetur ndonjë vend pa u përcjellë nga direkt Kryetari, nga drejtori përgjegjës, por edhe nga unë në disa pjesë ku kisha mundësi me përcjellë, sepse interesimi ka qenë i të gjithëve. Dëmet janë rishikuar dhe janë përcjellë dhe Drejtoria ka hapur aplikimin për gjitha dëmet që janë bërë, qoftë familjare, pronë ose biznes, të cilat me kalimin e kohës do të shqyrtohen dhe po besojë që do të kompensohen, kjo është edhe në faqen e Komunës dhe çdonjëri ka pasur çasje për me përcjellë gjendjen, po besoj me krahasuar me disa vite të kaluara në disa zona, kemi qenë më lehtë, por ka prona familjare që kanë kaluar keq dhe kemi parë drejtëpërdrejtë gjendjen dhe do të procedojmë me kohë gjithçka është në kontroll dhe besoj shumë që do ta bëjmë më të mirën e mundshme. Nëse ke diçka tjeter, sepse unë herën e fundit të kam premtuar që do ta jap një përgjigje në lidhje me rrugën prapë. Unë e kuptoj si të arsyeshëm shqetësimin tënd por i qëndroj besnik arsyetimit tim, përgjigja fakt edhe para këtyre të kam thënë që e din arsyen, sepse ajo rrugë është e paraparë të ndërtohet nga ministria si rrugë rajonale mirëpo me insistimin dhe gjendjen që është, është e paraparë të ndërhyjë menjëherë në dhjetor dhe janar nuk fillojnë punimet por do të mundohemi të gjejmë një rrugëzgjidhje dhe ka për tu kryer edhe ajo, jo me e pa si arsyetim por që e marr seriozisht çdo pyetje ose kërkesë nga çdo qytetarë, sepse po na krijohet nganjëherë një mëdyshje dhe nuk mbahet qejfi, sepse këtu nuk ka kuvendar, këtu ka njerëz që janë të interesuar për gjendjen e sigurisë në bashkësi dhe bashkërisht mundohemi që të gjejmë zgjidhje duke i adresuar kërkesat e juaja te vendi ose personi i duhur. Përndryshe, kjo është esenca e sigurisë në bashkësi,

por unë ju inkurajoj që të bissedojmë çkado që keni, vetëm ta dini se nuk jemi duke e luajtur rolin e Kryetarit ose të pushtetit dhe që pjesa tjetër janë asamble, ne jemi këtu gjithë bashkë me një synim kryesor dhe vetë prezencia e komandantit të Policisë, tregon që jemi për siguri dhe çdo rrugë që ka nevojë për ndërtim, riparim që shkon në sigurinë e qytetarit, për këtë jemi këtu, rrugë, shkollë pastaj e ke pasur një kërkesë shumë të mirë që ti ishe në grupin që ka filluar realizimi i shenjëzimit dhe pjesa tjetër që i takon komunikacionit. Mua më njoftoi drejtori përkatës, që këto ditë keni filluar dhe besoj që e ke këtë informatë, shenjat kanë filluar në vendet e duhura dhe pse jo kur ka kërkesa të duhura edhe ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë. Ka dikush diçka tjetër?

Z.Hazir Tigani: Unë desha të ndërlidhem me atë që Josipi e filloj te tema e vërvshimeve, është e vërtetë që kryetari me stafin e tij kanë qenë shumë aktiv dhe me këtë rast vetëm desha që t'i përgëzoj për angazhimin dhe interesimin që e kanë bërë, sepse unë vet kam qenë me ta dhe i kam parë që 24h pandërprerë kanë qenë me qytetarët, mirëpo vërvshimet e bëjnë të veten, besoj që kryetari bashkë me stafin e tij do t'ju dalin në ndihmë të gjithë atyre që kanë pësuar déme.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë!

Z. Fitim Bojaj, hoxhë: Përvshëndetje nën kryetare dhe ju të gjithë të pranishëm, unë desha dy pyetje, mos të them pyetje për komandantin por të bëjmë bisedë miqësisht këtu, të gjithë jemi prekur me rastin e kolegut tuaj, vëllait tonë që ka ndërruar jetë në aksidentin e javës së kaluar dhe kur thatë ju se të dyshuar nuk ka qenë një por kanë qenë më shumë dhe të janë më shumë e mos t'i ofrojnë ndihmë një njeriu në fatkeqësi është turp dhe e dyta për hajni deri ku kanë shkuar apo a është zbuluar ky grup i vjedhjeve, sepse është shqetësuese, e thatë edhe ju vet apo janë informata që nuk mund të shpërndahen në publik?

Z.Ragip Bytyqi, Komandant: Po hoxhë, në aksident kanë qenë të përfshirë edhe kamioni dhe një rimorkio që kanë qenë në lëvizje të drejtimit të Klinës, ndërkohë vetura e viktimit ka qenë duke shkuar në drejtim të Skenderajt d.m.th në kamion ka qenë një djali 20 vjeçar me prindin e tij, sa i përket rasteve të vjedhjeve ne i kemi 2-3 pista që i kemi por që nuk mund t'i publikoj, por çdo informacion është i mirëseardhur për ne.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit komandant, nëse ka dikush diçka, unë e pash që Silvia u lajmërua më vonë, nëse ka diçka.

Znj.Silvija Rashkovic: Mirëmbërema të gjithëve, situata është e qetë, situatën me tabela e kemi parë që është më e qetë edhe komandanti e di, diçka tjetër nuk kam.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit Silvija, edhe herën e kaluar kemi dhënë përgjigje për tabelën që është në nivelin e lartë politik që nuk ka të bëj me nivelin Komunal, uroj dhe më vjen mirë që s'ka pasur pasoja sa i përket vërvshimeve, dikush tjetër?

Komandat z.Ragip Bytyqi: Po e them haptas, me Silvijen kemi raporte, gjithashtu me secilin

prej jush, i kemi numrat e telefonit që shqetësimet e juaja t'i pranojmë në çdo kohë dhe nuk ka nevojë për shqetësim, ne mund të kemi kontakt edhe jashtë kësaj seance që e kemi, është fjalë sa i përket sigurisë.

Znj.Silvija Rashkovic: Shumë faleminderit për bashkëpunimin, dua të ju përgëzoj për një punë profesionale.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Nëse nuk ka dikush, diçka tjetër, kalojmë tek pika e fundit.

Pika 4. Të ndryshme.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Këtë pikë e kam lënë për ju, çkado që keni, të diskutoni kërkesë, sugjerim, ankesë, jemi të hapur kush dëshiron që ta marr fjalën.

Don Agim Qerkini: Përshëndetje, unë vetëm desha të arsyetoj mungesën për takimin e kaluar, fjalë është për numrin e telefonit, Josipi paska thënë që unë tash e disa muaj kam ndërruar numrin e telefonit, unë nuk kam ndërruar numër të telefonit tash e dy vite dhe telefonin e mbaj afér, javën e fundit të tetorit unë kam qenë jashtë Kosovës. Ndoshta edhe kanë provuar të më marrin në telefon, por unë s'kam ndërruar numër ,dhe e dyta unë nevojë përmes Josipit me ditë se kur mbahet mbledhja është në këtë drejtim ndoshta me punuar meqenëse nuk jemi shumë anëtarë të jemi më të informuar.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, Don Agim! E vërtetë, unë kështu e kam informatën, koordinatorja kryesore e ka bërë të pamundurën për të marr në telefon dhe tash pasi nuk është përfunduar e marrim fajin të dyja bashkë, sepse Josipi mirë e tha herën e kaluar nuk është larg, takimin e parë e kemi bërë me ftesë derë më derë, sepse nuk kishim mundësi njoftimi, e kemi bërë me letër përmes një punëtori në kuadër të Komunës, mirëpo unë kam menduar që është përfunduar, mungesa e koordinatores sigurisht që edhe këtu sot mungon dhe të kërkoj falje sinqerisht, duhet të jemi të kujdeshëm. Zakonisht e pyes a i ke njoftuar, gjithë thotë po, disa e konfirmojnë pjesëmarrjen por me rastin tënd u tha që është ndërruar numri i telefonit dhe ne menduam që e ke ndërruar dhe ramë në kontakt, të falënderoj që je këtu dhe kërkoj falje për herën e kaluar, vërejtje me vend, faleminderit.

Z.Ragip Bytyqi, Komandant: Format e komunikimit sot janë shumë të avancuara dhe kërkojë që koordinatorja të formojë një grup në Viber dhe në grup, përpos që kemi diçka për të komunikuar me njëri tjetrin, komunikojmë në grup, dhe kisha propozuar që koordinatorja ta hap një grup në Viber, nëse jeni dakord edhe ju.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Komandant, shumë faleminderit për idenë! Sot, është komentuar edhe nga Shemi për këtë variant, unë nuk e kam menduar më herët, por sot

teknologja është për të gjithë në çdo formë dhe besoj që në të ardhmen do të jemi të kujdeshëm, edhe njëherë kërkoj falje për çdonjën edhe pse ka raste shumë shpesh që e konfirmojnë pjesëmarrjen, por nuk arrijnë që të vijnë në takim, edhe kjo na ndodhë, por megjithatë po e pranojmë fajin.

Z.Josip Dedaj: Për herë të parë po e dëgjoj këtë!

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Zakonisht kur jam në faj e dëgjojnë gjithë, por rrallë jam në faj kështu që, se dëgjon shpesh. Nëse ka dikush tjetër diçka?

Z.Jeton Sokoli: Përderisa jemi te falja, edhe unë kërkoj falje për takimin e kaluar që s'kam qenë prezent, por kam pasur një operacion në këmbë, kështu që, kërkoj falje.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë! Po, na ke sqaruar edhe herën e fundit. Atëherë, kur nuk ka pyetje dhe diskutime në komunën e Klinës, gjithçka është duke shkuar mirë, më vjen mirë shumë.

Z.Fitim Bojaj, hoxhë: E kemi edhe një takim, a po?

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Po, ju kam sqaruar edhe herën e fundit, fillimi shift nuk gjemjë punë që nuk gjemjë nga pak gabime, unë kam menduar se fillimin kur e kemi pasur në janar dhe deri në janar me qenë gjashtë takime, por m'u tha që brenda vitit duhet të jenë gjashtë, për këtë arsy këto dy muajt e fundit i kemi mbajtur rrresh, e kemi edhe në muajin e ardhshëm, ku e caktojmë një ditë dhe ju njoftojmë.

Z.Fitim Bojaj, hoxhë: Pasi e kemi edhe një mbledhje, po e lëmë për mbledhjen e fundit atëherë, me rëndësi është që situata e sigurisë është e qetë, përpos rastit të vërvshimeve dhe aksidentit të vëllait tonë.

Z.Ragip Bytyqi, Komandant: Desha të shtoj edhe diçka rreth formimit të grupit në Viber. Pasi që si KKSB jemi në aspektin e sigurisë, unë besoj që ky grup do të kishte shërbyer edhe për informim në baza ditore nëse ndodh diçka, jashtë strukturës se çka duhet me informuar unë ju kisha informuar në grup dhe jo me ditë prej mëhalle. Unë nganjëherë kur të shkoj në qytet, në Pejë jetoj, e kur të shkoj, i marr shpesh infot nga gruaja, kështu që, ju i merrni informatat nga dora e parë si grup punues që jemi, ju kisha informuar për çdo incident që është në përmasa përtu informuar, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që të kërkoj unë ndihmë nga ju, sepse edhe ju që jeni kryesues në lagjet tuaja, e keni një ide dhe më thoni: Komandant, kjo është kështu. Një mendim të mirë, ne e implementojmë menjëherë, çka është e mirë dhe e dobishme në aspektin e sigurisë, besoj që me këtë grup do të funksionojmë mirë dhe do të jemi të suksesshëm dhe grupi si grup duhet të jemi shumë konfidencial që informatat t'i kemi vetëm ne.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, komandant, për këtë ide! Jam e bindur që do të dalë punë shtesë, por vetë e kërkove. Ju falënderoj për takimin e sotëm, natën e

mirë, shihemi në takimin e radhës!

Procesmbajtësja:

Orgeta Sylaj



KRYESUESJA:

Marqe Tanushi-Selmanaj

